



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 37, datë 17.12.2024

PËR
REFUZIMIN E LEJES PËR RISHIKIMIN E KUSHTEVE GJATË NDËRTIMIT PËR
OBJEKTIN: “OBJEKT ME FUNKSION HOTEL, BANIM,
ZYRA DHE SHËRBIME, 35 KATE MBI TOKË, ME 6 KATE NËNTOKË”,
ME VENDODHJE NE BASHKINË TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Nenit 25 të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” e ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues “Ferro Beton & Construction Co” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Refuzimin e Lejes për rishikimin e kushteve gjatë ndërtimit për objektin: “Objekt me funksion hotel, banim, zyra dhe shërbime, 35 kate mbi tokë, me 6 kate nëntokë, me vendodhje ne Bashkinë Tiranë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Ferro Beton & Construction Co” sh.p.k.
2. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.
4. Kundër këtij Vendimi, lejohet ankim nga pala e interesuar, sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në Ligj Nr. 44/2015 “Kodin e Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.



MINISTËR I LINJËS

MINISTRIA INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 19/05 2025